



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËVE SLLAVE DHE
BALLKANIKE



PROGRAMI I LËNDËS
Tipologji tekstore I

Titullari / pedagogu i lëndës: Dr Elvira Xhamani
Ngarkesa: 4 kredite; 40 orë mësimore; 40 seminare
Viti akademik: 2024-2025, Viti I, semestri II
Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme
Programi i studimit: Bachelor në “ Përkthim-Interpretim” në gjuhë ruse
Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)
Adresa elektronike e titullarit/e pedagogut të lëndës: elvira.xhamani@unitir.edu.al

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Kursi ka të bëjë me përsosjen e aftësive analitike dhe sintetike tek studentët, duke thelluar studimin e elementëve të ndryshëm gramatikore dhe leksikore (sinonimet, antonimet, perifrazimet etj.), duke i ofruar mundësinë për pasurimin e bagazhit gjuhësor dhe kulturor të gjuhës ruse. Të mësojë kërkimin bazë të tekstit; Të njihet me metodat dhe teknikat e analizave filologjike të tekstit. Të mësojë të planifikojë punën sipas etapave të caktuara. Të analizojë dhe të formojë një gjykim personal, të arsyeshëm dhe aktiv mbi burimet e ndryshme dhe literaturën e shfrytëzuar.

Objektivat specifike lëndore:

1. Thellimi i analizës së dukurive specifike gjuhësore në copa leximi me karakter të përgjithshëm dhe special, me tematikë nga fusha të ndryshme.
2. Zhvillimi i shprehive mbi frazeologjinë e gjuhës,
3. Zhvillimi i mikrobisedave dhe dialogëve për krijimin e situatave të larmishme gjuhësore.
4. Analizë tërësore e zgjeruar e copave të leximit duke u nisur nga ndarja tipologjike e tyre.

Rezultatet e pritshme.:

1. Të marrë në konsideratë tekstin si një formë të veçantë të komunikimit.
2. Të di kategoritë bazë dhe konceptet letrare.
3. Të njohë rregullsinë e ndërtimit të tekstit dhe qasjet kryesore në studimin e tij;
4. Të marrë në konsideratë tekstin si një unitet të përmbajtjes ideologjike.
5. Të analizojë strukturën poetike të formave dhe zhanëreve të ndryshëm.